

L I G J
Nr.8265, datë 18.12.1997

PËR ORGANIZIMIN E DREJTËSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
PUSHTETI GJYQËSOR

Neni 1

Pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga gjykatat në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencat e ngarkuara me ligj.

Neni 2

Gjykatat kanë kompetencë të shqyrtojnë të gjitha çështjet penale, penale ushtarake, civile, administrative, si dhe çdo çështje tjetër në qoftë se me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 3

Gjyqtarët në ushtrimin e funksioneve të tyre janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 4

Prokuroria është autoriteti që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATAVE

Neni 5

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Kasacionit.

Me ligj të veçantë, pranë gjykatave të shkallës së parë mund të krijohen edhe organizma për zgjidhjen e çështjeve me pajtim. Në ato mund të punojnë persona me kualifikim juridik më të ulët nga ato të parashikuar në nenin 19 të këtij ligji.

Neni 6

Gjykatat e shkallës së parë gjykojnë sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, nga tre gjyqtarë ose nga një gjyqtar dhe dy ndihmësgjyqtarë.

Neni 7

Gjykata e apelit gjykon në shkallë të dytë ankimet kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë.

Gjykatat e apelit gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Neni 8

Gjykatat ushtarake organizohen dhe funksionojnë brenda strukturave të pushtetit gjyqësor sipas kompetencave të përcaktuara me ligj.

Neni 9

Gjykatat ushtarake përbëhen nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit.

Neni 10

Gjykata ushtarake e apelit shqyrton në shkallë të dytë ankimet kundër vendimeve të gjykatave ushtarake të shkallës së parë. Ajo gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Neni 11

Gjykatat e shkallës së parë organizohen dhe funksionojnë në rrethe gjyqësore në të gjithë territorin e vendit. Kompetencat tokësore dhe qendra e ushtrimit të veprimtarisë për secilën prej tyre caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë dhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykatat e apelit funksionojnë në zona të caktuara nga Presidenti i Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë dhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 12

Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të të gjitha hallkave gjyqësore caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 13

Gjykata e Kasacionit është autoriteti më i lartë gjyqësor që realizon kontrollin gjyqësor për zbatimin e drejtë dhe të njëlojtë të ligjeve. Ajo shqyrton, në përputhje me Dispozitat Kushtetuese dhe me ligjin, rekursat kundër vendimeve të të gjitha gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. Gjykata e Kasacionit ka qendrën në Tiranë.

Vendimet në kolegjet e bashkuara merren me shumicën e votave të gjyqtarëve të saj. Kur votat janë të barabarta vota e kryetarit është përcaktuese, përveç rasteve kur gjykohen çështje penale, ku vota e barabartë është në favorin e të gjykuarit.

Neni 14

Kryetarët e gjykatave bëjnë organizimin e brendshëm të punës në gjykatë dhe ushtrojnë funksione të tjera administrative të parashikuara me ligj.

Në fillim të çdo viti, kryetari i gjykatës së apelit dhe kryetari i gjykatës së shkallës së parë, përcakton për vitin në vazhdim shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma penale e civile të gjykatës.

Në dhomën e çështjeve civile përfshihen edhe gjyqtarët e seksioneve për gjykimet e posaçme.

Kur madhësia e gjykatës nuk lejon të organizohen të paktën një dhomë civile dhe një dhomë penale, ndarja e çështjeve bëhet midis të gjithë gjyqtarëve në mënyrë të barabartë.

Neni 15

Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short.

Neni 16

Pranë gjykatave të të gjitha hallkave caktohen edhe një numër i mjaftueshëm prokurorësh. Numri i përgjithshëm i prokurorëve caktohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 17

Vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta.

Pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë krijohet Inspektorati.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë emëron inspektorët gjyqtarë dhe inspektorët prokurorë, të cilët ngarkohen të inspektojnë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, si dhe prokuroritë pranë tyre, verifikojnë ankesat e shtetasve dhe të institucioneve, organizimet e shërbimeve gjyqësore, të bëjnë evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në kuptimin e nenit 45 të këtij ligji dhe ngarkesën në punë, si dhe në tërësi efencen e gjykatave dhe të prokurorive.

Ministri i Drejtësisë vë në dispozicion të grupeve të inspektimit specialistët e tij për të ndihmuar në kryerjen e detyrave të mësipërme, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me aftësi profesionale të gjyqtarëve.

Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë përcaktohet në rregulloren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 18

Pushteti gjyqësor ka buxhet të veçantë i cili administrohet prej tij sipas ligjit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është person juridik publik dhe veprimtaria e tij financohet nga buxheti i shtetit si zë i veçantë.

KREU III

KUSHTET PËR T'U PRANUAR GJYQTAR DHE PROKUROR I GJYKATËS I SHKALLËS SË PARË DHE TË APELIT

Neni 19

Mund të punojnë si gjyqtarë dhe prokurorë shtetasit shqiptarë që plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Të jenë diplomuar si jurist, pas kryerjes së studimeve të rregullta dhe të plota universitare në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.
3. Të kenë përfunduar Shkollën e Magjistraturës.
4. Të mos kenë qenë të dënuar me heqje lirie dhe të gëzojnë reputacion të mirë.
5. Të jenë jo më pak se 25 vjeç.

Neni 20

Mund të caktohen si gjyqtarë dhe prokurorë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë pa ju nënshtruar formimit në Shkollën e Magjistraturës edhe juristë të tjerë, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji, në qoftë se kanë punuar jo më pak se pesë vjet si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë apo në Shkollën e Magjistraturës, deputetë, këshilltarë juridikë në Kuvendin Popullor, në Presidencë, në Këshillin e Ministrave dhe juristë specialistë në Ministrinë e Drejtësisë ose që kanë kryer kurse specializimi pasuniversitar afatgjata jashtë shtetit.

Kjo e drejtë u njihet edhe juristëve të diplomuar në vende të tjera, sipas përcaktimeve në legjislacionin shqiptar ose në marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 21

Kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë që përmbushin kushtet e mësipërme, emërohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Kriteret objektive të seleksionimit dhe të paraqitjes së kandidaturave përcaktohen në rregulloren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 22

Para fillimit të detyrës, gjyqtarët dhe prokurorët bëjnë betimin si më poshtë:

"Betohe më solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kudoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale".

Betimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të porsa emëruar bëhet para gjyqtarëve dhe prokurorëve të instancës ku janë caktuar për të kryer detyrën.

Neni 23

Vendet vakantë për gjyqtarë e prokurorë duhet të shpallen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 24

Gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatës së apelit emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë pasi të kenë punuar jo më pak se pesë vjet në gjykatat e shkallës së parë dhe në kryerjen e detyrës të kenë manifestuar cilësi të larta etiko-morale dhe profesionale.

Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit dhe drejtuesit e zëvendës drejtuesit e prokurorëve pranë këtyre gjykatave, emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Neni 25

Gjyqtarët dhe prokurorët mund të qëndrojnë në detyrë deri në moshën 65 vjeç.

KREU IV STATUTI I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Neni 26

Gjyqtarët dhe prokurorët gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit që i ka zgjedhur ose emëruar, me përjashtim të rasteve kur kryejnë një krim të dukshëm (flagrant) për të cilin parashikohet një dënim jo më pak se 5 vjet burg.

Neni 27

Gjyqtarët dhe prokurorët nuk mund të lëvizin nga detyra me përjashtim të rasteve kur:

1. japin dorëheqjen;
2. mbushin moshën për pension;
3. dënohen me heqje lirie me vendim të formës së prerë;
4. konkludohet që janë të paaftë për të kryer detyrën, bazuar në kritere objektive, sipas të cilave merret një vendim nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
5. nuk fitojnë provimin periodik profesional të organizuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
6. merren masa disiplinore nga organi kompetent, në rastet e parashikuara nga ky ligj;
7. kryen veprime që bien ndesh me nenet 29, 30 e 31 të këtij ligji.

Në rastet kur ndaj një gjyqtari ose prokurori vendoset fillimi i çështjes penale, ai mund të pezullohet nga detyra, derisa vendimi të marrë formë të prerë.

Në rast se fajësia nuk është vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ose prokurori ka të drejtë të rikthehet në punën e mëparshme, duke marrë edhe pagën për të gjithë kohën

që ka qenë i pezulluar.

Neni 28

Ngritja në përgjegjësi e gjyqtarit, si dhe transferimi mund të bëhet vetëm me pëlqimin e tyre, përveç rasteve të parashikuara nga ky ligj.

Në rastet kur një gjykatë nuk funksionon normalisht për shkak të mungesës së përkohëshme të gjyqtarëve ose për shkak të mbingarkesës së punës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të ministrit të Drejtësisë, mund të delegojë gjyqtarë nga gjykata të tjera për një periudhë jo më shumë se tre muaj në vit edhe pa pëlqimin e gjyqtarit. Në raste të veçanta ky delegim mund të përsëritet dhe për tre muaj.

Me mbarimin e këtij afati gjyqtari kthehet në vendin e mëparshëm.

Ministri i Drejtësisë, për çështje të veçanta, mund të ngarkojë një gjyqtar për të gjykuar në një gjykatë tjetër të së njëjtës shkallë.

Për nevoja pune Prokurori i Përgjithshëm mund të transferojë prokurorin vartës në një prokurori tjetër deri në gjashtë muaj.

Neni 29

Gjyqtarëve dhe prokurorëve u ndalohet të bëjnë pjesë në parti politike ose të marrin pjesë në veprimtari me karakter politik.

Neni 30

Funksioni i gjyqtarit dhe prokurorit është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor, si dhe me çdo funksion dhe veprimtari tjetër publik ose privat, me përjashtim të funksioneve të mësimëdhënies në shkollat e larta dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Neni 31

Gjyqtarëve dhe prokurorëve u ndalohet të ushtrojnë veprimtari tregtare, të marrin pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive civile ose tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi.

Ata nuk mund të jenë ekspertë ose arbitra të palëve në arbitrazh.

Neni 32

Gjyqtarit i ndalohet të bëjë deklaratë në lidhje me proceset, të bëjë të ditur mendimet që janë dhënë gjatë seancave të gjykimit që akoma nuk kanë marrë formën e një vendimi, akte ose dokumente zyrtare me karakter sekret ose vetjak.

Neni 33

Gjyqtarët gjatë gjykimit të çështjeve duhet të respektojnë solemnitetin e gjykimit dhe të mbajnë veshje të posaçme.

Neni 34

Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të ruajnë dinjitetin e tyre, duke moslejuar veprime që kompromentojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tyre në shoqëri.

Neni 35

Gjyqtarët dhe prokurorët janë të lirë të krijojnë shoqata ose organizata, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre si dhe për ngritjen profesionale.

Neni 36

Për të garantuar rendin dhe sigurinë, pranë gjykatave dhe prokurorive organizohet shërbimi i vazhdueshëm i policisë.

Neni 37

Asnjë gjyqtar nuk do të përgjigjet në një padi civile, e cila lidhet me kryerjen e detyrave të tij profesionale. Përgjegjësia civile e tyre parashikohet me ligj të veçantë.

Neni 38

Gjyqtari dhe prokurori kanë të drejtë:

1. Të kenë një mbrojtje të veçantë të vehtes, familjes dhe pronës kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze.
2. Të përfitojnë falas fletoret zyrtare, gazetatat dhe revistat juridike.

Neni 39

Gjyqtarët dhe prokurorët përfitojnë leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh. Leja vjetore bëhet në muajt korrik dhe gusht.

Gjyqtarët dhe prokurorët e ngarkuar me kryerjen e detyrave të ngutshme për periudhën korrik-gusht, lejen vjetore e bëjnë në një periudhë tjetër, duke përfutur 5 ditë shtesë.

KREU V PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Neni 40

Gjyqtarët dhe prokurorët kanë përgjegjësi për shkeljet e disiplinës, si dhe për kryerjen e veprimeve që cenojnë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë.

Neni 41

Konsiderohen shkelje të disiplinës:

1. Kryerja e veprimeve që sipas ligjit janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit dhe prokurorit;
2. nxjerrja e sekretit të hetimit, të dhomës së këshillimit ose të të dhënave të tjera me karakter intim;
3. zvarritje të rënda ose sistematike në kryerjen e detyrës;
4. mosrespektimi i rregullave të solemnitetit;
5. mungesat pa arsye në punë;
6. kryerja e veprimeve të pahijshme ose amorale brenda dhe jashtë kohës së punës;
7. kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale, kur nuk përbën vepër penale;
8. moszbatimi pa arsye i masës disiplinore të dhënë.

Neni 42

Për shkelje të disiplinës ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve merren këto masa:

1. Vërejtje
2. Vërejtje me paralajmërim
3. Ulje në pagë deri në masën 25% për një periudhë nga tre deri në gjashtë muaj
4. Pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës ose prokurorisë për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit

5. Transferim në një gjykatë ose prokurori tjetër
6. Largim nga detyra

Neni 43

Masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve merren nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në bazë të vlerësimit të llojit dhe të karakterit të shkeljes së kryer.

Neni 44

Procedimi disiplinor për gjyqtarët vihet në lëvizje nga ministri i Drejtësisë, ndërsa për prokurorët nga Prokurori i Përgjithshëm.

Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet brenda tre vjetëve nga data e kryerjes të shkeljes.

Gjatë verifikimit, që bëhet nga inspektorët gjyqtarë ose prokurorë, përcaktohet nëse është kryer ndonjë shkelje e disiplinës nga ato të përcaktuara në ligj, lloji dhe rëndësia e shkeljes, fajësia e personit, si dhe të dhëna mbi të cilat mbështeten përfundimet e nxjerra.

Në çdo rast duhet të dëgjohet edhe gjyqtari apo prokurori që ka kryer shkeljen. Verifikimi i pretendimeve është i detyrueshëm.

Rezultatet e verifikimeve të bëra, si dhe të dhënat shkresore rreth tyre, pasqyrohen në një akt përfundimtar, i cili i bëhet i njohur gjyqtarit apo prokurorit që ka kryer shkeljen.

Materialet, sipas rastit, i dërgohen ministrit të Drejtësisë ose Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë para se të marrë vendimin, duhet të dëgjojë pretendimet e palëve në një seancë tjetër. Materialet e plota i vihen në dispozicion gjyqtarit ose prokurorit 10 ditë përpara zhvillimit të seancës. Këta kanë të drejtë të mbrohen vetë ose me avokat gjatë seancës.

Neni 45

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, jo më vonë se një herë në dy vjet, bën vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, duke u bazuar në cilësinë, volumin e punës, shpejtësinë e gjykimeve, reputacionin dhe punimet juridike të publikuara sipas përcaktimit të mëposhtëm:

1. Shumë mirë
2. Mirë
3. Mjaftueshëm
4. I paaftë

Vlerësimi si më sipër i komunikohet gjyqtarit, i cili ka të drejtën e ankimit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë brenda 10 ditëve nga marrja e tij. Këshilli i Lartë i Drejtësisë shqyrton ankimin duke zbatuar rregullat e parashikuara në paragrafin e fundit të nenit 44 të këtij ligji.

Kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të bëhet ankim në Gjykatën e Kasacionit. Vlerësimi "i paaftë" përbën shkak për shkarkimin nga detyra.

Shqyrtimi i ankimit ndaj këtij vendimi në Këshillin e Lartë të Drejtësisë bëhet sipas rregullit të parashikuar në paragrafin e fundit të nenit 44 të këtij ligji.

Neni 46

Gjyqtari ose prokurori, ndaj të cilit merret çdo masë disiplinore, si dhe kur shkarkohet nga detyra, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Kasacionit. Shqyrtimi bëhet nga kolegjet e bashkuara.

KREU VI DISPOZITAT TRANZITORE

Neni 47

Pika 3 e nenit 19 të këtij ligji nuk zbatohet deri në përfundimin e formimit në Shkollën e Magistraturës të grupit të parë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.

Në rast shkrirjeje të një gjykate, në aktin përkatës të organit kompetent, të parashikohen edhe mundësitë e sistemimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vende të tjera të sistemit të drejtësisë.

Neni 48

Gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar në kundërshtim me kriteret ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e emërimit dhe që në të njëjtën kohë nuk plotësojnë kriteret profesionale e morale sipas këtij ligji, largohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është i detyruar të shqyrtojë çdo rast të veçantë, pasi të marrë edhe mendimin e shoqatave të juristëve, të avokatëve apo gjyqtarëve.

Personat e mësipërm mund të emërohen në detyra të tjera më të ulëta, si ndihmës gjyqtarë, nëpunës në administratën gjyqësore, në përmbarim ose në policinë gjyqësore, si dhe në administratën publike, në përputhje me nivelin e tyre arsimor dhe shkallën e kualifikimit, sipas kriterëve të ligjit "Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë".

Neni 49

Ligji nr.7574, datë 24.6.1992 "Për organizimin e Drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile", me ndryshimet e mëvonëshme, shfuqizohen.

Neni 50

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1976, datë 23.12.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**